

MATEMATIKA AF KL 1-6 (600 pyetje)

Pyetja 1.

Nga dy stacione A e B që janë larg 376 km, nisen njëkohësisht përkundrajt njëri-tjetrit dy trena. Sa km larg do të jenë pas gjysëm ore, nëse i pari ecën me shpejtësi $102\frac{\text{km}}{\text{orë}}$ dhe i dyti me shpejtësi $144\frac{\text{km}}{\text{orë}}$:

- A) 250
- B) 253
- C) 258
- D) 268

Pyetja 2.

Nëna e Anit është 25 vjeçe. Pas 5 vitesh ajo do të jetë sa trefishi i moshës së Anit. Në çfarë moshe nëna e Anit do të jetë sa dyfishi i moshës së Anit:

- A) 35 vjeçe
- B) 38 vjeçe
- C) 40 vjeçe
- D) 50 vjeçe

Pyetja 3.

Rrota e biçikletës bën 2 rrotullime në sekondë. Nëse perimetri i rrotës është 1.5 dm, sa kilometra rrugë bën biçikleta për 1 orë.

- A) 1,04 km
- B) 1,08 km
- C) 11,8 km
- D) 12,2 km

Pyetja 4.

Cilat nga shprehjet e mëposhtme janë të vërteta:

- A) gjestohen me 2 vetëm numrat që mbarojnë me shifrën 2,4,6,8.

- B) pjestohen me 5 vetëm numrat që mbarojnë me 5.
- C) pjestohen me 3 të gjithë numrat që mbarojnë me 3 ose 6 ose 9.
- D) pjestohen njëkohësisht me 2 dhe 5 ato numra që mbarojnë me zero.

Pyetja 5.

Perimetri i një trekëndëshi barabrinjës është 2 herë më i vogël se ai i një katrori, dhe perimetri i katrorit është 3 herë më i madh se perimetri i një rrombi me brinjë 5 cm. Sa është brinja e trekëndëshit barabrinjës:

- A) 10
- B) 12
- C) 15
- D) 20

Pyetja 6.

Lira ka 34 pako, ku ne secilen prej tyre gjenden nga 18 fletore. Ajo do t'ua shpërndajë në mënyrë të barabartë 15 shoqeve. Sa fletore do ti teprojnë pas shperndarjes:

- A) 8 copë
- B) 10 copë
- C) 12 copë
- D) 14 copë

Pyetja 7.

Emi bleu 4 fletore nga 20 lekë secila, 5 stilolapsa nga 25 lekë secila dhe disa lapsa me nga 7 lekë copa. Sa lapsa bleu ajo nëse ka shpenzuar 161 lekë:

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9

Pyetja 8.

Një shitëse ka blerë dy copa të të njëjtit stof dhe ka paguar 3990 Lekë dhe 3325 Lekë. Copat e dytë e stofit është 7 metra më pak se e para. Sa është gjatësia në metra të dy copave së bashku

- A) 47 m
- B) 57 m
- C) 67 m
- D) 77 m

Pyetja 9.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) Çdo numër i plotë është negativ.
- B) Çdo numër i plotë është numër natyrorë.
- C) Vetëm numrat e plotë pozitivë janë natyrorë.
- D) Vetëm numrat natyrorë dhe zero janë numra të plotë .

Pyetja 10.

Dy drejtëza prerëse në një plan mund të formojnë:

- A) dy kënde të gjërë e dy të ngushtë.
- B) dy kënde të ngushtë e dy të drejtë.
- C) një kënd të drejtë e tre të ngushtë.
- D) një kënd të gjërë, një kënd të ngushtë dhe dy kënde të drejtë.

Pyetja 11.

Sa djagonale të ndryshme ka një gjashtëkëndësh:

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9

Pyetja 12.

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) Drejtëkëndëshi është katror dhe rromb.
- B) Katrori është rromb dhe drejtëkëndësh.
- C) Paralelogrami është katërkëndësh dhe trapez.
- D) Rrombi është trapez dybrinjëshëm.

Pyetja 13.

Cila është figura gjeometrike plane që ka 4 brinjë të barabarta, këndet përballë të barabartë dhe diagonalet pingule dhe jo të barabarta:

- A) Drejtëkëndëshi
- B) Katrori
- C) Paralelogrami
- D) Rrombi

Pyetja 14.

Masat e këndeve të një trapezi mund të jenë:

- A) 15° ; 135° ; 45° ; 60°
- B) 47° ; 24° ; 72° ; 183°
- C) 75° ; 25° ; 105° ; 165°
- D) 90° ; 90° ; 62° ; 108°

Pyetja 15.

Sa faqe ka një prizëm 5-këndor:

- A) 5
- B) 6

- C) 7
- D) 8

Pyetja 16.

Sa brinjë ka një prizëm 6-këndor:

- A) 6
- B) 12
- C) 15
- D) 18

Pyetja 17.

Sa boshte simetrie ka një qark:

- A) 1
- B) 2
- C) 4
- D) Pafundësi

Pyetja 18.

Në një system koordinativ këndrejtë, cilat janë kordinatat plane të simetrikes së pikës $(-2,3)$, në lidhje me origjinen e koordinative:

- A) $(2,3)$
- B) $(2,-3)$
- C) $(-2,-3)$
- D) $(3,2)$

Pyetja 19.

Gjej pohimin e vërtetë:

- A) Çdo kordë është diametër.
- B) Çdo pikë brenda rrethit është e barazlarguar nga qendra e rrethit.
- C) Rrethi ka një pafundësi kulmesh.
- D) Rrethi s'ka kulme.

Pyetja 20.

Koncepti i klasifikimit bazohet mbi konceptin:

- A) e pasqyrimit.
- B) e relacionit funksional.
- C) e relacionit të ekujvalencës.
- D) e relacionit të renditjes.

Pyetja 21.

Një shishe është mbushur me ujë $\frac{3}{4}$ e sajë. Për t'a mbushur deri në $\frac{8}{9}$ e saj, edhe ç'pjesë duhet t'i shtojmë:

- A) $\frac{10}{72}$
- B) $\frac{7}{36}$
- C) $\frac{3}{16}$
- D) $\frac{12}{72}$

Pyetja 22.

Cilat nga pohimet e mëposhtme është i vërtete:

- A) Kemi vetëm një numër të fundëm thyesash të barabarta me një thyes të dhënë.
- B) Nëse marr një pjesë nga biskota e ndarë në katër pjesë të barabarta atëherë kam marr $\frac{1}{4}$.
- C) Një pastë e ndarë në tri pjesë jep thysën $\frac{1}{3}$.

D) Thysat paraqesin numra të plotë.

Pyetja 23.

Vlera e shprehjes $13\frac{5}{7} \div 4\frac{4}{5}$ është:

A) $\frac{40}{14}$

B) $\frac{18}{7}$

C) $\frac{5}{14}$

D) $\frac{64}{35}$

Pyetja 24. Sa minuta është $\frac{3}{5}$ e ditë-natës:

A) 720 min

B) 664 min

C) 820 min

D) 864 min

Pyetja 25.

Një shofer bëri $\frac{1}{4}$ e rrugës orën e parë, dhe $\frac{4}{9}$ e rrugës orën e dytë. Ç'pjesë e rrugës i ka mbetur akoma për të bërë:

A) $\frac{22}{72}$

B) $\frac{10}{36}$

C) $\frac{12}{36}$

D) $\frac{3}{9}$

Pyetja 26.

Mirela duhet të zgjidhë për 5 ditë disa ushtrime. Katër ditët e para zgjidhi nga $\frac{1}{5}$ e ushtrimeve në çdo ditë. Ditën e pestë zgjidhi $\frac{1}{6}$ e ushtrimeve. Ç'pjesë e ushtrimeve janë pa u zgjidhur:

- A) I kanë mbetur $\frac{1}{30}$ e ushtrimeve.
- B) I kanë mbetur $\frac{1}{15}$ e ushtrimeve.
- C) I kanë mbetur $\frac{4}{30}$ e ushtrimeve.
- D) Mirela i zgjidhi gjithë ushtrimet.

Pyetja 27.

Ersida planifikoj të lexonte librin për 8 ditë në pjesë të barabarta çdo ditë. 3 ditët e para lexoi sipas planifikimit, 2 ditë u sëmurë. Ç'pjesë të librit duhet të lexojë në mënyrë të barabartë në ditët e mbetura që t'a mbarojë librin brenda 8 ditëve:

- A) $\frac{3}{8}$
- B) $\frac{7}{24}$
- C) $\frac{9}{16}$
- D) $\frac{10}{48}$

Pyetja 28.

1 hektometër sa centimeter ka:

- A) 10 cm
- B) 100 cm
- C) 10000 cm
- D) 100000 cm

Pyetja 29.

Cila madhësi nuk matet direkt:

- A) gjatësia e një segmenti
- B) koha që zgjatë një ndeshje volejboli
- C) pesha e një trupi
- D) sipërfaqja e një drejtëkëndëshi

Pyetja 30.

Hersi i dy numrave është 3. Cilët mund të jenë numrat x e y:

- A) 15 me 5
- B) 2 me
- C) 3 me $\frac{1}{6}$
- D) 3x me x

Pyetja 31.

Të masësh një madhësi do të thotë:

- A) të masësh masën e një trupi.
- B) të krahasosh një madhësi me një madhësi tjetër.
- C) të krahasosh një madhësi me një madhësi tjetër të të njëjtit lloj, që është zgjedhur si njësi matëse.
- D) të peshosh një trup me kilogram.

Pyetja 32.

Në orë mbetet mbrapa në çdo orë 12 sekonda. Pas sa ditësh ora do të jetë mbrapa 1 orë:

- A) 8 ditë
- B) 8,5 ditë
- C) 10,5 ditë
- D) 12,5 ditë

Pyetja 33.

Cila figurë ka vetëm një bosht simetrie:

- A) Rrethi
- B) Rrombi
- C) Trapezi dybrinjëshëm
- D) Trekëndëshi tribrinjëshëm

Pyetja 34.

Cila figurë ka më shumë çifte boshtesh simetrie pingule me njëri-tjetrin:

- A) Drejtkëndëshi
- B) Katrori
- C) Rrethi
- D) Rrombi

Pyetja 35.

Jepet trekëndëshi ABC me kordinata: $A(-3,3)$; $B(-3,-1)$ dhe $C(1,-1)$. E zhvendosi në rrjetin koordinativ sipas vektorit BC. Marrim vektorin $A'B'C'$. syprina e $A'B'C'$ është e barabartë me:

- A) 6 cm^2
- B) 8 cm^2
- C) 10 cm^2
- D) 12 cm^2

Pyetja 36.

Jepet trekendeshi ABC me kordinata : A(-3,3), B(-3,-1) dhe C(1,-1). E zhvendosi në rrjetin koordinativ sipas homotetisë me qendër origjinën e koordinatave e me koefiçient

2. Marrim vektorin A'B'C'. syprina e A'B'C' është e barabartë me:

- A) 8 cm^2
- B) 16 cm^2
- C) 26 cm^2
- D) 32 cm^2

Pyetja 37.

Jepet një tabelë:

temperatura	dendësia
18	2
19	4
20	3
21	5
22	6
23	7
24	4

Mesatarja është:

- A) 21,16
- B) 21,17
- C) 21,48
- D) 21,59

Pyetja 38.

Jepet një tabelë:

temperatura	dendësia
18	2
19	4

20	3
21	5
22	6
23	7
24	4

Moda është:

- A) 18
- B) 22
- C) 23
- D) 24

Pyetja 39.

Në një kuti ka: 5 tapa blu, 4 tapa të verdha, 3 tapa të kuqe dhe 8 tapa të gjelbërta. Fusim dorën dhe nxjerrim një tapë. Cili është probabiliteti që tapa e nxjerrë është e verdhë ose e kuqe:

- A) $\frac{4}{7}$
- B) $\frac{3}{7}$
- C) $\frac{7}{20}$
- D) $\frac{13}{20}$

Pyetja 40.

Në shkrimin rromak numri 55 shkruhet:

- A) LV
- B) VC
- C) VL
- D) XXXXX

Pyetja 41.

Në shkrimin rromak numri 554 shkruhet:

- A) VDL
- B) DLIV
- C) VVIV
- D) VVIII

Pyetja 42.

Për të mbuluar sipërfaqen e një dritareje drejtkëndore me përmasa 108 cm e 72 cm me copa letërnjitëse, Ana përdor katrorë me brinjë:

- A) 7 cm
- B) 8 cm
- C) 10 cm
- D) 12 cm

Pyetja 43.

Dy rubineta mbushin një çisternë dhe një rubinet i tretë e zbraz atë. Në një orë rubineti i parë sjell 32 litra, i dyti 17 litra dhe e treti zbraz 9 litra. Pas 1 dite e 17 orësh sa litra do të jenë sjellë në çisternë:

- A) 940
- B) 1040
- C) 1600
- D) 1640

Pyetja 44.

Dy vazo reçeli të së njëjtës cilësi kushtojnë respektivisht 3240 lekë dhe 1800 lekë. E para përmban 12 kg më shumë se e dyta. Gjeni sa kg ka secila vazo:

- A) 27 kg dhe 12 kg
- B) 30 kg dhe 12 kg

- C) 27 kg dhe 15 kg
- D) 30 kg dhe 15 kg

Pyetja 45.

Dy vazo reçel të së njëjtës cilësi kushtojnë respektivisht 3240 lekë dhe 1800 lekë. E para përmban 12 kg më shumë se e dyta. Sa kushtojnë 3 kg reçel:

- A) 120 lekë
- B) 180 lekë
- C) 320 lekë
- D) 360 lekë

Pyetja 46.

Gjeni cila është e saktë: Në një shprehje më parë kryhen:

- A) Shumzimi ose pjestimi, mbledhja ose zbritja.
- B) Veprimet në kllapa, pastaj ato jashtë kllapave, dhe në të dy rastet shumzimi ose pjestimi dhe pastaj mbledhja ose zbritja.
- C) Veprimet në kllapa, pastaj mbledhja, shumzimi, zbritja, pjestimi.
- D) Veprimet në kllapa, pjestimi ose shumzimi pastaj zbritja ose mbledhja.

Pyetja 47.

Cila nga shprehjet e mëposhtme është e sakte. Thysa është e barabartë me një numër natyror kur:

- A) Emëruesi është nënfish i numëruesit.
- B) Emruesi shpreh ndarjen e të tërës në pjesë të barabarta.
- C) Kur emëruesi është shumfish i numëruesit.
- D) Kur emëruesi shpreh ndarjen e të tërës në pjesë sa është ndarë edhe numëruesi.

Pyetja 48.

Është dhënë thyesa $\frac{50}{15}$. Sa do të jetë numëruesi i thyesës së barabartë me të, që e ka emëruesin 9:

- A) 27
- B) 28
- C) 30
- D) 35

Pyetja 49.

Një enë u mbush me $\frac{2}{3}$ litra ujë, pastaj me $\frac{4}{5}$ litra ujë e më pas $\frac{3}{4}$ litra. Në fund u zbraz $\frac{4}{7}$ e ujit të mbledhur. Sa litra ujë mbeti në enë:

- A) $\frac{79}{70}$
- B) $\frac{133}{140}$
- C) $\frac{64}{70}$
- D) $\frac{148}{140}$

Pyetja 50.

Një kuti kishte 180 bombone. Beni gjysmën ia shpërndau shokëve, $\frac{1}{3}$ kushurinjtë dhe $\frac{1}{15}$ për vete. Sa bombone mbetën në kuti:

- A) 15
- B) 18
- C) 20
- D) 21

Pyetja 51.

Shumkëndësh i rregullt është:

- A) drejtkëndëshi
- B) katrori
- C) paralelogrami
- D) rrombi

Pyetja 52.

Shumkëndësh i rregullt quhet shumkëndëshi:

- A) që ka brinjët ose këndët e barabartë.
- B) që ka diagonalet që dalin nga i njëjti kulm të barabartë.
- C) që ka këndet dhe brinjët e barabarta.
- D) që ka të gjithë brinjët dhe diagonalet e barabarta.

Pyetja 53.

Cili përkufizim është i saktë: Lartësi e trekëndëshit quhet:

- A) Segmenti i pingules së hequr nga njëri kulm në qendrën e trekëndëshit.
- B) Segmenti i pingules së tërhequr nga njëri kulm i trekëndëshit mbi brinjën përballë, ose mbi zgjatimin e saj.
- C) Segmenti i hequr nga kulmi që bie pingul me mesin e brinjës përballë.
- D) Segmenti që bashkon njërin kulm të trekëndëshit, me mesin e brinjës përballë.

Pyetja 54.

Kur mund të ndërtoj trekëndësh në rastet e mëposhtme:

- A) $\hat{A}=52^\circ \hat{B}=73^\circ \hat{C}=25^\circ$
- B) $\hat{A}=82^\circ \hat{B}=45^\circ \hat{C}=50^\circ$
- C) $\hat{A}=74^\circ \hat{B}=51^\circ \hat{C}=59^\circ$
- D) $\hat{A}=63^\circ 30' \hat{B}=62^\circ 30' \hat{C}=54^\circ$

Pyetja 55.

Kur mund të ndërtohet trekëndëshi në rastet e mëposhtme:

- | | | |
|--------------|----------|----------|
| A) $a=12$ cm | $b=5$ cm | $c=6$ cm |
| B) $a=17$ cm | $b=8$ cm | $c=9$ cm |
| C) $a=7$ cm | $b=9$ cm | $c=4$ cm |
| D) $a=8$ cm | $b=4$ cm | $c=4$ cm |

Pyetja 56.

Cilët nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) Katrori është drejtkëndësh dhe jo rromb.
- B) Paralelogrami i ka diagonalet e barabarta.
- C) Rrombi i ka diagonalet pingule.
- D) Trapezi i ka dy brinjë paralele dhe dy të barabarta.

Pyetja 57.

Me të dhënat e mëposhtme, kur mund të ndërtohet rrombi **ABCD**:

- | | | | |
|---------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| A) $\hat{A} = 72^0$ | $\hat{B} = 18^0$ | $\hat{C} = 18^0$ | $\hat{D} = 72^0$ |
| B) $\hat{A} = 54^0$ | $\hat{B} = 126^0$ | $\hat{C} = 54^0$ | $\hat{D} = 126^0$ |
| C) $\hat{A} = 65^0$ | $\hat{B} = 65^0$ | $\hat{C} = 115^0$ | $\hat{D} = 115^0$ |
| D) $\hat{A} = 77^0$ | $\hat{B} = 84^0$ | $\hat{C} = 77^0$ | $\hat{D} = 90^0$ |

Pyetja 58.

Trapezi mund të jetë:

- A) këndrejtë e dybrinjshëm.
- B) këndrejtë me dy brinjë të barabarta.
- C) me të gjitha brinjët e barabarta.
- D) me të gjitha këndet e barabarta.

Pyetja 59.

Në një katërkëndësh të çfarëdoshëm $ABCD$, nëse $\hat{A} = 60^\circ; \hat{B} = 90^\circ; \hat{C} = 60^\circ$, atëherë këndi \hat{D} do të jetë:

- A) 90°
- B) 120°
- C) 150°
- D) 180°

Pyetja 60.

Sa numra dhjetorë me vetëm dy shifra pas presjes ka ndërmjet numrave 2,1 dhe 2,17

- A) asnjë
- B) 3
- C) 5
- D) 6

Pyetja 61.

Zbritni numrat 10,4 me 3,1. Shifra e njësheve tek diferenca do të jetë:

- A) 2
- B) 5
- C) 6
- D) 7

Pyetja 62.

Është dhënë vargu: **5,7; 4,3; 2,9;...** Kufiza e shtatë e këtij vargu do të jetë:

- A) -0,1
- B) 0,1
- C) -2,7
- D) 2,7

Pyetja 63.

Gjej cilat barazime shkronjore janë të vërtetapër të gjitha numrat natyrorë:

- A) $a-1=a+1$
- B) $b+b=3b$
- C) $x:8=8:x$
- D) $x:1=x$

Pyetja 64.

Është dhënë inekuacioni $14x < 64$ në bashkësinë e përcaktimit $\{2,3,5\}$. Bahkësia e zgjidhjeve është:

- A) $\{2,3\}$
- B) $\{5,6,7\}$
- C) $\{5\}$
- D) $\{5,6\}$

Pyetja 65.

Janë dhënë katrori me brinjë 33mm dhe drejtkëndëshi me brinjë 123mmdhe 9mm. Dy figurat:

- A) janë figura të barabarta.
- B) janë figura të ngjashme.
- C) kanë syprina të barabarta.
- D) kanë syprina të ndryshme.

Pyetja 66.

$18000\text{ml}=x$ hektolitër. Cila është vlera e x :

- A) 1,8 hektolitër
- B) 0,0018 hektolitër
- C) 0,18 hektolitër
- D) 0,018 hektolitër

Pyetja 67.

Një pompë shkarkon 15 litër ujë në 30 sekonda në një çisternënë formë kuboidi me përmasa 1,5 m; 0,8 m; dhe 1 m. Për sa minuta mbushet depozita:

- A) 35 min
- B) 40 min
- C) 55 min
- D) 60 min

Pyetja 68.

Cili është pohimi i saktë :

- A) Çdo çifti numrash i përgjigjet një pikë në boshtin koordinativ.
- B) Në një çift të radhitur numrash i përgjigjet një pikë e vetme në planin koordinativ.
- C) Vendodhja e çdo pike në planin koordinativ përcaktohet nga një çift numrash real.
- D) Vendodhja e një pike në një plan koordinativ, përcaktohet nga një koordinatë.

Pyetja 69.

Në rrjetin koordinativ, bashkësia e pikave që e kanë ndryshesën e ordnatave të çfarëdoshme dhe abshisën të barabartë me 3 formojnë:

- A) drejtëz që kalon në pikën (6,3).
- B) drejtëz që kalon nga origjina e koordinatave.
- C) drejtëz që kalon nga pika (3,0).
- D) rreth.

Pyetja 70.

Një figure i janë zmadhuar tre hërë koordinatat e pikave. Transformimi që është kryer është:

- A) homoteti me qëndër origjinën e koordinatave.
- B) simetri në lidhje me një drejtëz.
- C) simetri në lidhje me origjinën e koordinatave.

D) zhvendosje paralele me vektor me gjatësi tre njësi.

Pyetja 71.

Në cilin transformim të një rrjeti nuk ndryshon vendodhja:

- A) Në simetrimë qëndrore me qëndërbrënda rrethit (jo në qëndër të tij).
- B) Në simetrimë qëndrore me qëndër jashta rrethit.
- C) Në simetrimë qëndrore me qëndër në një pikë të rrethit.
- D) Në simetrimë qëndrore me qëndër, qendrën e rrethit.

Pyetja 72.

Një rreth me qëndër pikën O nuk e ndryshon vendodhjen në:

- A) homotetinë $(O,2)$.
- B) homotetinë $(A,1)$ ku A është një pikë e rrethit.
- C) homotetinë $(A,2)$ ku A ndodhet dy njësi larg qendrës O të rrethit.
- D) në homotetinë $(O,1)$.

Pyetja 73.

Le të kemi simetrimë në lidhje me një drejtëz d të një rrethi me qëndër O e rreze r . Simetriku i këtij rrethi me vetë rrethin priten vetëm në një pikë A . Në këtë rast drejtëza d e simetrisë:

- A) ka distancë me të madhe se r nga qendra O .
- B) ka distancë më të vogël se r nga qendra O .
- C) ka distancë r nga qendra O .
- D) kalon nga qendra O .

Pyetja 74.

Jepet vargu: **1; 4; 9; 16;...** Kufiza e tetë do të jetë:

- A) 45

- B) 49
- C) 64
- D) 81

Pyetja 75.

Jepet vargu: **3; 6; 10; 15;...** Kufiza e tetë është :

- A) 43
- B) 44
- C) 45
- D) 46

Pyetja 76.

Një kavanoz zë 400g reçel. Sa kavanoza reçel duhen për të ambalazhuar 1kv e 800g reçel:

- A) 196 copë
- B) 252 copë
- C) 258 copë
- D) 260 copë

Pyetja 77.

Mira përgatiti një ëmbëlsirë me 400g miell dhe 130g sheqer. Nëse Mira përgatit një ëmbëlsirë me 1,4kg miell, atëherë ajo duhet të përdorë:

- A) 390g sheqer
- B) 450g sheqer
- C) 455g sheqer
- D) 485g sheqer

Pyetja 78.

Një veturë ecën me shpejtësi 110km/orë dhe pas çdo dy orësh udhëtim bën 30 min pushim. Një kamion nisat njëkohësisht me të në të njëjtin drejtim dhe udhëton me shpejtësi 65km/orë pa ndaluar. Sa larg janë ato pas 7 orësh:

- A) 150km
- B) 280km
- C) 300km
- D) 310km

Pyetja 79.

Distanca në mes qyteteve A e B është 375 km. Nga këto dy qytete nisen përkundrejt njëra-tjetrës dy makina. Njëra ecën me 60km/orë tjetra me 65km/orë. Pas sa orësh këto dy makina takohen:

- A) 3 orësh
- B) 3,4orësh
- C) 2,8orësh
- D) 3,8orësh

Pyetja 80.

Një euro këmbëhet me 140,6lekë. Njëeuro këmbëhet me 1,25dollar. Një dollar këmbëhet me:

- A) 110,8lekë
- B) 112,8lekë
- C) 111,48lekë
- D) 112,48lekë

Pyetja 81.

Një euro këmbëhet me 140,0lekë. Një dollar këmbëhet me 112,0lekë. Këmbimi euro – dollar është:

- A) 1,25
- B) 1,26
- C) 1,255

D) 1,265

Pyetja 82.

Shitësi i një dyqani ushqimor shet 20 pako biskota me çmim 30 lekë pakon. Nëse ai i ka blerë në pikën e shumicës me 25lekë pakon,sa lekë është fitimi i tij:

- A) 90 lekë.
- B) 100 lekë.
- C) 105 lekë.
- D) 110 lekë.

Pyetja 83.

Një librashitës bleu në shtëpinë botuese një seri librash që kushton 13800lekë.Ai pagoi dhe 1200lekë për transportin. Nëse i shet të gjithë librat 18800lekë,sa lekë fiton ai:

- A) 3800 lekë.
- B) 4800 lekë.
- C) 5000 lekë.
- D) 5200 lekë.

Pyetja 84.

Një shitës grumbulloi nga shitja e 12 çokollatave 600lekë dhe realizoi një fitim prej 96lekësh. Me sa lekë e ka blerë ai një çokollatë:

- A) 36 lekë.
- B) 40 lekë.
- C) 42 lekë.
- D) 52 lekë.

Pyetja 85.

Një lulëshitës shet 36 karafila natyralë me çmimin 200lekë copa. Nëse ai i ka blerë të gjithë karafilat 5400lekë, sa lekë është fitimi i tij:

- A) 150 lekë.
- B) 1800 lekë.
- C) 1900 lekë.
- D) 2000 lekë.

Pyetja 86.

Një shitëse pijesh shet një shishe Coca-Cola 120lekë, të cilën e ka blerë 83lekë. Sa lekë fiton ajo nga shitja e 14 shisheve Coca-Cola:

- A) 37 lekë.
- B) 512 lekë.
- C) 518 lekë.
- D) 600 lekë.

Pyetja 87.

Një shitës bananesh bleu të një pikë shumice 200copë banane, që i kushtuan 2800lekë. Fitimi i tij për çdo banane që shet është 6 lekë. Sa lekë e shet ai çdo banane:

- A) 15 lekë.
- B) 20 lekë.
- C) 25 lekë.
- D) 30 lekë.

Pyetja 88.

Një librashitës bleu 37kopje të një libri me nga 900lekë secilin dhe llogariti që t'i shiste me 1500lekë secilin. Më vonë vuri re se 7 kopje ishin me difekt. Me sa lekë duhet t'i shesë tani librat e mbetur pa difekt, që të sigurojë po të njëjtin fitim:

- A) 1530 lekë.
- B) 1580 lekë.
- C) 1600 lekë.

D) 1850 lekë.

Pyetja 89. Pasi të kryhen veprimet rezultati i shprehjes $3-(-7)+(-2) \cdot (-1)-(-3) \cdot 2$ del:

- A) -18
- B) -16
- C) 12
- D) 18

Pyetja 90.

Pasi të kryhen veprimet rezultati i shprehjes $7 \cdot (-2) - 3 \cdot 4 - (-6) + (-2) - 1 \cdot 3$ del:

- A) -25
- B) -21
- C) 21
- D) 25

Pyetja 91.

Kur klasifikojmë elemente të një bashkësie ne:

- A) përcaktojmë një funksion.
- B) përcaktojmë një pasqyrim.
- C) përcaktojmë një relacion ekuivalent.
- D) përcaktojmë një relacion radhitje.

Pyetja 92.

Kur klasifikojmë elementët e një bashkësie ne:

- A) e caktojmë bashkësinë.
- B) e ndajmë bashkësinë në nënbashkësi prerëse dy nga dy.
- C) e ndajmë bashkësinë në nënbashkësi të ndryshme ku njëra është nënbashkësi boshe.
- D) e ndajmë bashkësinë në një numër të pafundëm nënbashkësish.

Pyetja 93.

Le të kemi disa të dhëna: **6; 6; 8; 10; 12; 6; 6; 10; 20; 25; 10; 5**. Numri **6** tregon:

- A) mesore
- B) mesataren
- C) moden
- D) vlerën me të ulët.

Pyetja 94.

Mësuesja, pasi mati gjatësinë trupore të nxënësve të klasës ndërtoi këtë tabelë:

Gjatësia	134	140	142	143	149	151	153
Denduria	2	4	3	3	6	9	3

Mesatarja do të jetë:

- A) 144
- B) 145,5
- C) 146,5
- D) 146,8

Pyetja 95.

Mësuesja në klasën e pestë ju thotë nxënësve: “Të dalin para klasës dy nxënës që mësojnë anglisht”. Kjo ngjarje do të jete e pa mundur nëse :

- A) është vetëm një nxënës në klasë që mëson anglisht.
- B) të gjithë nxënësit e klasës mësojnë frengjisht dhe anglisht.
- C) të gjithë klasa mëson anglisht.
- D) të paktën dy nxënës të klasës mësojnë anglisht.

Pyetja 96.

Kur hedhim zarin (kubi që ka në faqet e tij një deri në gjashtë pika),probabiliteti që të bierë treshi është :

- A) $\frac{1}{5}$
- B) 1
- C) 0
- D) $\frac{1}{6}$

Pyetja 97.

Kur e hedhim zarin (kubi që ka në faqet e tij një deri në gjashtë pika),probabiliteti që të bierë 7 është:

- A) $\frac{1}{5}$
- B) 1
- C) 0
- D) $\frac{1}{6}$

Pyetja 98.

Mohimi i pohimit $a=0 \vee b=0$ është :

- A) $a \neq 0 \vee b = 0$
- B) $a = 0 \vee b \neq 0$
- C) $a \neq 0 \vee b \neq 0$
- D) $a \neq 0 \wedge b \neq 0$

Pyetja 99.

Probabiliteti i një ngjarjeje është çdo numër:

- A) $P \in R^-$
- B) $0 \leq P$
- C) $0 \leq P \leq 1$
- D) $P \leq 1$

Pyetja 100.

Dyshemetë drejtkëndore të dhomave X dhe Y kanë të njëjtën sipërfaqe. Nëse dhoma X është 12 m e gjërë dhe 18 m e gjatë dhe dhoma Y ka gjatësi 9 m, sa është gjërësia e dhomës Y në metra:

- A) $13\frac{1}{2}$
- B) 18
- C) $18\frac{3}{4}$
- D) 24

Pyetja 101.

Nëse shumat e 5, 8, 12 dhe 15 është e barabartë me shumën e 3, 4 dhe $x+3$. Sa është vlera e x :

- A) 14
- B) 15
- C) 16
- D) 17

Pyetja 102.

Për cilën nga vlerat e mëposhtme të n , vlera e shprehjes $\frac{100+n}{n}$ nuk është numër i plotë:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 103.

Shuma e numrave të thjeshtë më të mëdhenj se 60 dhe më të vegjël se 70 është:

- A) 67
- B) 128
- C) 191

D) 197

Pyetja 104.

Në një varg rritës 10 numrash të plotë të njëpasnjëshëm, shuma e 5 numrave të plotë të parë është 560. Sa është shuma e 5 numrave të fundit të kësaj sekuence:

- A) 585
- B) 580
- C) 575
- D) 570

Pyetja 105.

Raporti i 2 me $\frac{1}{3}$ është i barabartë me raportin e:

- A) 6 me 1
- B) 3 me 2
- C) 2 me 3
- D) 1 me 6

Pyetja 106.

Cila është shifra e 25-të pas presjes dhjetore e numrit me presje $\frac{6}{11}$:

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 107.

Nëse numri n është pozitiv dhe i plotë, atëherë $n(n+1)(n+2)$, cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë:

- A) është çift vetëm kur n është çift.
- B) është çift vetëm kur n është tek.
- C) plotëpjestohet me 3 vetëm kur n është tek.
- D) plotëpjestohet me 3 sa herë që n është tek.

Pyetja 108.

Nëse $x > 0$, çfarë përqindje e x -it është $\frac{x}{50} + \frac{x}{25}$:

- A) 6%
- B) 25%
- C) 37%
- D) 60%

Pyetja 109.

Nëse $5 - \frac{6}{x} = x$, atëherë sa vlera reale të mundshme mund të ketë x :

- A) Asnjë
- B) Dy
- C) Nje
- D) Një numër të pafundëm

Pyetja 110.

Nëse raporti $\frac{a}{b}$ është pozitiv, cila nga pohimet e mëposhtëm duhet të jetë i vërtetë:

- A) $b > 0$
- B) $ab > 0$
- C) $a - b > 0$
- D) $a + b > 0$

Pyetja 111.

Nëse **m** është mesatarja aritmetike e 10 numrave të pare pozitivë shumëfisha të 5 dhe nesë **M** është mesorja e 10 numrave të pare pozitivë shumëfisha të 5. Cila është vlera e **M-m**:

- A) -5
- B) 0
- C) 5
- D) 25

Pyetja 112.

Makina A është 20 km pas makines B, e cila po ecën me të njëjtin drejtim në të njëjtën rrugë si makina A. Makina A ecën me shpejtësi konstante 58 km/h kurse makina B ecën me shpejtësi konstante 50 km/h. Sa orë i duhen makinës A të parakalojë makinën B me 8 km:

- A) 2 orë
- B) 2.5 orë
- C) 3 orë
- D) 3.5 orë

Pyetja 113.

Në një test me dy pyetje të organizuar nga shkolla, 75 % e klasës iu përgjigj pyetjes së parë saktë, 55% e klasës iu përgjigj pyetjes së dytë saktë dhe 20% e klasës nuk iu përgjigjën saktë asnjërës nga pyetjet. Cila është përqindja e klasës që iu përgjigj të dy pyetjeve në mënyrë të saktë:

- A) 10%
- B) 30%
- C) 50%
- D) 65%

Pyetja 114.

$p \Rightarrow q$ është e njëvlershëm me:

- A) $p \wedge \bar{q}$
- B) $\bar{p} \vee q$
- C) $\bar{p} \wedge \bar{q}$
- D) $p \vee q$

Pyetja 115.

Cili nga barazimet logjike të mëposhtme është i vërtetë:

- A) $\overline{p \wedge q} = \bar{p} \wedge \bar{q}$
- B) $\overline{p \wedge q} = \bar{p} \wedge q$
- C) $\overline{p \wedge q} = \bar{p} \vee \bar{q}$
- D) $\overline{p \wedge q} = \bar{p} \vee q$

Pyetja 116.

Kemi tre pohime të thjeshta **p,q** dhe **r**. Sa kombinime të mundshme të vlerave të vërtetësisë të këtyre pohimeve të mundshme kemi:

- A) 3
- B) 6
- C) 8
- D) 9

Pyetja 117.

Nga barazimet logjike të mëposhtëm cili është i vërtetë:

- A) $\bar{p} \vee \bar{q} = p \Rightarrow \bar{q}$
- B) $\bar{p} \vee \bar{q} = \bar{p} \Rightarrow q$
- C) $\bar{p} \vee \bar{q} = \overline{p \vee q}$
- D) $\bar{p} \vee \bar{q} = \overline{p \wedge q}$

Pyetja 118.

Nga barazimet logjike të mëposhtëm cili është i vërtetë:

A) $\overline{p \Rightarrow q} = \overline{p} \wedge q$

B) $\overline{p \Rightarrow q} = \overline{p} \wedge \overline{q}$

C) $\overline{p \Rightarrow q} = \overline{p} \vee q$

D) $\overline{p \Rightarrow q} = p \wedge \overline{q}$

Pyetja 119.

Nga barazimet logjike të mëposhtëm cili është i vërtetë:

A) $p \Leftrightarrow q = p \Rightarrow q \vee q \Rightarrow p$

B) $p \Leftrightarrow q = (\overline{p} \vee q) \wedge (\overline{q} \vee p)$

C) $p \Leftrightarrow q = (\overline{p} \Rightarrow q) \wedge (\overline{q} \Rightarrow p)$

D) $p \Leftrightarrow q = \overline{p \vee q}$

Pyetja 120.

Nga barazimet logjike të mëposhtëm cili është i vërtetë:

A) $\overline{\overline{p}} = p$

B) $\overline{p \Rightarrow q} = \overline{q} \Rightarrow p$

C) $\overline{p \Rightarrow q} = \overline{p} \wedge \overline{q}$

D) $\overline{p \Rightarrow q} = p \vee \overline{q}$

Pyetja 121. Cila nga fjalitë e mëposhtme është pohim:

A) Agimi është djalë i mirë

B) Agimi është shtatlartë.

C) Agimi është zeshkan.

D) Agimi ka kryer fakultetin e mësuesisë.

Pyetja 122. Cilët nga grumbujt e mëposhtëm formon bashkësi:

- A) Studentët bjondë të fakultetit.
- B) Studentët e fakultetit të mësuesisë.
- C) Studentët këmbëngulës të një fakulteti
- D) Studentët shtatlartë të një fakulteti .

Pyetja 123. Sa elemente ka bashkësia **fuqi** $P(A)$ ku $A=\{1,2,3\}$:

- A) 2
- B) 4
- C) 6
- D) 8

Pyetja 124. Sa elemente ka bashkësia **fuqi** $P(A)$ ku $A=\{1,2,3,4\}$:

- A) 6
- B) 8
- C) 12
- D) 16

Pyetja 125.

Janë dhënë bashkësia A dhe B , të tilla që $A \subset B$. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) A dhe B formojnë një coptim.
- B) $A \cap B \subseteq A$
- C) $A \cup B \subseteq A$
- D) $B \subseteq A \cap B$

Pyetja 126.

Janë dhënë bashkësia A dhe B, të tilla që $A \subset B$. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- A) $B - A = B$
- B) $A \cap B = B$
- C) $A \cup B = A$
- D) $A \cup B = B$

Pyetja 127.

Është dhënë predikati: $x^2 - 1 < 0$ në \mathbb{Z} . Bashkësia e vlerave të vërtetësisë është:

- A) \emptyset
- B) \mathbb{Z}
- C) \mathbb{Z}^-
- D) $\{0\}$

Pyetja 128.

Është dhënë predikati: $x^2 - 1 \leq 0$ në \mathbb{Z} . Bashkësia e vlerave të vërtetësisë është:

- A) \emptyset
- B) $\{0\}$
- C) $\{-1, 0, 1\}$
- D) \mathbb{Z}

Pyetja 129.

Është dhënë predikati: $x^2 - 1 \leq 5$ në \mathbb{Z} . Cila është bashkësia e vlerave të vërtetësisë:

- A) $\{0, 1, 2\}$
- B) \emptyset
- C) $\{-1, -2\}$

D) $\{-2,-1,0,1,2\}$

Pyetja 130.

Jepet ekuacioni: $-x^2 - 3x = 5$ në \mathbb{N} . Cila është bashkësia e vlerave të vërtetësisë:

A) $\{2,3,4\}$

B) $\{-2,0\}$

C) \emptyset

D) $\{-1,1\}$

Pyetja 131.

Jepet sistemi:

$$\begin{cases} x - 3y = -2 \\ 3x + 5y = 8 \end{cases}$$

Cila është bashkësia e vlerave të vërtetësisë:

A) $(-1,-1)$

B) $(-2,2)$

C) $(-1,1)$

D) $(1,1)$

Pyetja 132.

Cila është bashkësia e vlerave të vërtetësisë: $x < y$ e përcaktuar në $A \times A$ ku $A = \{1,2,3,4\}$

A) $\{(1,2)(3,4)\}$

B) $\{(1,2)(2,3)(3,4)\}$

C) $\{(2,4)(1,4)(3,4)\}$

D) $\{(1,2)(1,3)(1,4)(2,3)(2,4)(3,4)\}$

Pyetja 133.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar:

- A) $\exists m \in \mathbb{N}, m-2=0$
- B) $\forall n \in \mathbb{N}, \exists m \in \mathbb{N}, n < m.$
- C) $\forall x \in \mathbb{R}^+, \exists y \in \mathbb{R}, y < x$
- D) $\forall n \in \mathbb{N}, n^2-4 \neq 0$

Pyetja 134.

Le të jetë dhënë pohimi: “Ka numra natyrorë që janë katrorë të plotë të ndonjë numri natyrorë”. Paraqitja me anë të sasiorëve dhe simbolikës do të jetë:

- A) $(\exists n \in \mathbb{N})(\forall m \in \mathbb{N})(n = m^2)$
- B) $(\exists n \in \mathbb{N})(\exists m \in \mathbb{N})(n = m^2)$
- C) $(\forall n \in \mathbb{N})(\forall m \in \mathbb{N})(n = m^2)$
- D) $(\forall n \in \mathbb{N})(\exists m \in \mathbb{N})(n = m^2)$

Pyetja 135.

Është dhënë pohimi: $(\exists n \in \mathbb{N})(\forall x \in \mathbb{N})(x \leq n)$. Mohimi i tij do të jetë:

- A) $(\exists n \in \mathbb{N})(\forall x \in \mathbb{N})(x \geq n)$
- B) $(\forall n \in \mathbb{N})(\forall x \in \mathbb{N})(x > n)$
- C) $(\forall n \in \mathbb{N})(\exists x \in \mathbb{N})(x > n)$
- D) $(\forall n \in \mathbb{N})(\exists x \in \mathbb{N})(x \geq n)$

Pyetja 136.

Cili nga pohimet e mëposhtëm shpreh vetinë pasqyruese të relacionit **R**:

- A) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R a) \Rightarrow a \equiv b$
- B) $\forall a \in A, a R a$
- C) $\forall a, b \in A a R b \Rightarrow b R a$
- D) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R c) \Rightarrow a R c$

Pyetja 137.

Cili nga pohimet e mëposhtme shpreh vetinë simetriketë relacionit **R**:

- A) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R a) \Rightarrow a \equiv b$
- B) $\forall a \in A, a R a$
- C) $\forall a, b \in A a R b \Rightarrow b R a$
- D) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R c) \Rightarrow a R c$

Pyetja 138. Cili nga pohimet e mëposhtëm shpreh vetinë kalimtare të relacionit **R**:

- A) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R a) \Rightarrow a \equiv b$
- B) $\forall a \in A, a R a$
- C) $\forall a, b \in A a R b \Rightarrow b R a$
- D) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R c) \Rightarrow a R c$

Pyetja 139.

Cili nga pohimet e mëposhtëm shpreh vetinë antisimetrike të relacionit **R**:

- A) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R a) \Rightarrow a \equiv b$
- B) $\forall a \in A, a R a$
- C) $\forall a, b \in A a R b \Rightarrow b R a$
- D) $\forall a, b \in A (a R b \wedge b R c) \Rightarrow a R c$

Pyetja 140.

Cili nga përkufizimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) Relacioni **R** quhet relacion ekuivalence nëse ai është njëkohësisht pasqyrues, simetrik, antisimetrik dhe kalimtarë.
- B) Relacioni **R** quhet relacion ekuivalence nëse ai është njëkohësisht pasqyrues, antisimetrik dhe kalimtar.
- C) Relacioni **R** quhet relacion ekuivalence nëse ai është njëkohësisht pasqyrues, kalimtar dhe simetrik.

D) Relacioni **R** quhet relacion ekuivalence nëse ai është njëkohësisht simetrik dhe antisimetrik.

Pyetja 141.

164 turistë kanë vizituar muzeun. Gjeni sa ka kushtuar bileta e hyrjes, nëse 44 vizitorë kanë hyrë falas dhe shuma e përgjithshme e paguar është 4800 lekë. Cila është shprehja që i jep zgjidhjen problemës:

- A) $(164-44):4800$
- B) $(164-44)\cdot 4800$
- C) $4800:164-44$
- D) $4800:(164-44)$

Pyetja 142.

Nga një libër me 570 faqe lexojmë 10 faqe çdo orë. Po të lexojmë nga 2 orë çdo ditë, sa faqe do të na mbeten për të lexuar pas një jave: Cila është shprehja që jep zgjidhjen e problemës:

- A) $(570-2\cdot 7)\cdot 10$
- B) $570-2\cdot 10\cdot 7$
- C) $(570-10\cdot 2)\cdot 7$
- D) $(570-2\cdot 10):7$

Pyetja 143.

Mamaja bleu për ditëlindjen e djalit 4 kg amareta, të cilat kushtonin nga 480 lekë kilogrami dhe 6 torta të vogla. Cila është shprehja që jep, sa ka kushtuar një tortë, nëse ajo shpenzoi gjithsej 3720 lekë:

- A) $4\cdot 480+6\cdot 3720$
- B) $(3720-4\cdot 480):6$
- C) $(3720-480)\cdot 4:6$
- D) $(3720-480\cdot 6):4$

Pyetja 144. Cili nga numrat e mëposhtëm plotpjestohet njëkohësisht me 9 dhe 11:

- A) 34278
- B) 200754
- C) 7424955
- D) 45543663

Pyetja 145. Cili nga numrat e mëposhtëm plotpjestohet njëkohësisht me 3 dhe 5:

- A) 21393
- B) 427315
- C) 733745
- D) 3100350

Pyetja 146. Cili nga numrat e mëposhtëm plotpjestohet njëkohësisht 2 dhe 11:

- A) 73247112
- B) 10207214
- C) 542753
- D) 152702

Pyetja 147.

Cili nga numrat e mëposhtëm është i thjeshtë:

- A) 2
- B) 33
- C) 39
- D) 51

Pyetja 148.

Sa numra të thjeshtë janë më të vegjël se 20:

- A) 6
- B) 7
- C) 8
- D) 9

Pyetja 149.

Sa numra të thjeshtë janë më të vegjël se 30:

- A) 7
- B) 8
- C) 10
- D) 11

Pyetja 150.

Numri 17160 mund të shkruhet si prodhim katër numrash natyrorë të njëpasnjëshëm. Në këtë prodhim numri i parë do të jetë:

- A) 7
- B) 9
- C) 10
- D) 12

Pyetja 151.

Numri 17160 mund të shkruhet si prodhim katër numrash natyrorë të njëpasnjëshëm. Në këtë prodhim numri i fundit do të jetë:

- A) 11
- B) 12
- C) 13
- D) 14

Pyetja 152. Herësi i secilit prej numrave çift me një numër të thjeshtë na jep vargun e numrave natyrorë. Për cilin numër të thjeshtë bëhet fjalë:

- A) 2
- B) 3
- C) 5
- D) 7

Pyetja 153. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) Herësi i dy numrave të thjeshtë është një numër i thjeshtë.
- B) Herësi i dy numrave të thjeshtë është numër natyrorë.
- C) Prodhimi i dy numrave të thjeshtë është i thjeshtë.
- D) Prodhimi i dy numrave të thjeshtë është gjithmonë i përbërë.

Pyetja 154. Cilat nga çiftet e mëposhtme të thyesave janë të barabarta:

- A) $\frac{135}{17}$ me $\frac{213}{33}$
- B) $\frac{23}{134}$ me $\frac{45}{262}$
- C) $\frac{53}{67}$ me $\frac{371}{469}$
- D) $\frac{13}{27}$ me $\frac{25}{53}$

Pyetja 155. Cilat nga çiftet e mëposhtme të thyesave janë të barabarta.

- A) $\frac{18}{17}$ me $\frac{19}{18}$
- B) $\frac{22}{14}$ me $\frac{33}{21}$
- C) $\frac{7}{5}$ me $\frac{9}{7}$
- D) $\frac{10}{9}$ me $\frac{11}{10}$

Pyetja 156.

Kemi të dhënë: $\frac{73}{15} = \frac{X}{135}$. Vlera e **X** do të jetë:

- A) 542
- B) 616
- C) 657
- D) 684

Pyetja 157.

Cilat nga thysat e mëposhtme janë numra dhjetorë të fundëm:

- A) $\frac{13}{2^2 \cdot 5^3}$
- B) $\frac{3^4}{3^2 \cdot 5^7}$
- C) $\frac{34}{7 \cdot 2^3}$
- D) $\frac{24}{2 \cdot 5 \cdot 3^3}$

Pyetja 158.

Cilat nga thysat e mëposhtme janë numra dhjetorë të fundëm:

- A) $\frac{15}{6}$
- B) $\frac{12}{35}$
- C) $\frac{13}{8}$
- D) $\frac{21}{18}$

Pyetja 159.

Cilat nga thysat e mëposhtme janë numra dhjetorë të fundëm:

- A) $\frac{13}{15}$
- B) $\frac{22}{45}$
- C) $\frac{36}{17}$
- D) $\frac{17}{125}$

Pyetja 160.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 3420 është:

- A) $2^2 \cdot 3^2 \cdot 5 \cdot 17$
- B) $2 \cdot 3 \cdot 5 \cdot 19$
- C) $2^2 \cdot 3^2 \cdot 5 \cdot 19$
- D) $4 \cdot 9 \cdot 5 \cdot 19$

Pyetja 161.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 1638 është:

- A) $2 \cdot 3^3 \cdot 9 \cdot 1$
- B) $2 \cdot 3 \cdot 5 \cdot 91$
- C) $2 \cdot 3^3 \cdot 91$
- D) $2^2 \cdot 3^2 \cdot 9^2$

Pyetja 162.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 5040 është:

- A) $2 \cdot 3^3 \cdot 9$
- B) $2 \cdot 23 \cdot 9 \cdot 7$
- C) $2^4 \cdot 3^2 \cdot 7 \cdot 5$
- D) $2^4 \cdot 5^2 \cdot 7 \cdot 3$

Pyetja 163.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 2860 është:

- A) $2 \cdot 3^3 \cdot 5$
- B) $13 \cdot 11 \cdot 2^2 \cdot 5$
- C) $17 \cdot 11 \cdot 5$
- D) $2^4 \cdot 5^2 \cdot 7 \cdot 3$

Pyetja 164.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 81000 është:

- A) $2^2 \cdot 3^4 \cdot 5^5$
- B) $2^4 \cdot 3^5 \cdot 5^4$
- C) $2^2 \cdot 3^5 \cdot 5^4$
- D) $2^3 \cdot 3^4 \cdot 5^3$

Pyetja 165.

Zbërthimi në faktorë të thjeshtë i numrit 2340 është:

- A) $2 \cdot 3^4 \cdot 5 \cdot 19$
- B) $2 \cdot 3 \cdot 5 \cdot 17$
- C) $2^2 \cdot 3^2 \cdot 5 \cdot 13$
- D) $3^2 \cdot 9 \cdot 5 \cdot 17$

Pyetja 166.

Jepet shprehja: $\frac{50}{21} : \frac{25}{14}$. Herësi është:

- A) $\frac{225}{42}$
- B) $\frac{4}{3}$
- C) $\frac{8}{7}$
- D) $\frac{5}{7}$

Pyetja 167.

Jepet shprehja: $\frac{26}{33} : \frac{52}{11}$. Herësi është:

- A) $\frac{1}{3}$
- B) $\frac{2}{12}$
- C) $\frac{3}{4}$
- D) $\frac{5}{3}$

Pyetja 168.

Vlera e shprehjes $(\frac{1}{2} + \frac{1}{3}) : (1 - \frac{1}{6}) - \frac{1}{4}$ është:

- A) $\frac{3}{4}$
- B) $\frac{4}{3}$
- C) $\frac{5}{3}$
- D) $\frac{3}{5}$

Pyetja 169.

Vlera e shprehjes $(\frac{8}{3} : (\frac{4}{5} + \frac{2}{3} + \frac{6}{5}) + \frac{3}{4}) - 1$ është:

- A) $\frac{13}{12}$
- B) $\frac{16}{14}$
- C) $\frac{25}{14}$
- D) $\frac{27}{34}$

Pyetja 170.

Vlera e shprehjes $((\frac{5}{6} + \frac{3}{10} + \frac{4}{15}) : (1 - \frac{3}{4}) - \frac{3}{5}) : \frac{14}{5}$ është:

- A) $\frac{21}{14}$
- B) $\frac{34}{28}$
- C) $\frac{25}{14}$
- D) $\frac{36}{28}$

Pyetja 171.

Në një kopsht me lule, karafila janë $\frac{12}{25}$ e të gjitha luleve. Tulipanë 3 herë më pak se karafila. Ndersa $\frac{1}{25}$ e luleve janë tharë. Pjesa që mbetet, ndahet në dy pjesë të barabarta midis trëndafilave dhe zambakëve. Gjeni ç'pjesë përfaqësojnë trëndafilat në kopsht:

- A) $\frac{6}{25}$
- B) $\frac{7}{50}$
- C) $\frac{8}{50}$
- D) $\frac{3}{25}$

Pyetja 172.

Sa është $\frac{3}{11}$ e $\frac{23}{7}$:

- A) $\frac{21}{253}$
- B) $\frac{69}{21}$
- C) $\frac{69}{77}$
- D) $\frac{34}{77}$

Pyetja 173.

Nga një tortë ka mbetur ende edhe $\frac{3}{4}$ e saj. Nëse hamë edhe $\frac{1}{4}$ e pjesës së mbetur, ç'pjesë e gjithë tortës mbetet pa ngrënë:

- A) $\frac{1}{4}$
- B) $\frac{10}{16}$
- C) $\frac{8}{16}$
- D) $\frac{9}{16}$

Pyetja 174.

Gjeni numrin, $\frac{3}{4}$ e të cilit është 63. Ai është:

- A) 48
- B) 84
- C) 92
- D) $\frac{189}{4}$

Pyetja 175.

Bora, pasi shpenzoi $\frac{1}{3}$ e lekëve që kishte, depozitoi në bankën e kursimeve $\frac{5}{6}$ e mbetjes. I mbetën për të shpenzuar ende edhe 12000 lekë. Sa lekë kishte Bora në fillim:

- A) 120000
- B) 110000
- C) 108000
- D) 102000

Pyetja 176.

Bora, pasi shpenzoi $\frac{1}{3}$ e lekëve që kishte, depozitoi në bankën e kursimeve $\frac{5}{6}$ e mbetjes. I mbetën për të shpenzuar ende edhe 12000 lekë. Sa lekë ka harxhuar Bora:

- A) 36000
- B) 34000
- C) 32000
- D) 30000

Pyetja 177.

Bora, pasi shpenzoi $\frac{1}{3}$ e lekëve që kishte, depozitoi në bankën e kursimeve $\frac{5}{6}$ e mbetjes. I mbetën për të shpenzuar ende edhe 12000 lekë. Sa lekë futi në bankë Bora:

- A) 70000
- B) 60000
- C) 54000
- D) 50000

Pyetja 178. Vlera e shprehjes: $\frac{(5+\frac{1}{4})-\frac{2}{3}}{\frac{8}{5}-(7+\frac{5}{8})}$ është:

- A) $\frac{74}{117}$
- B) $\frac{25}{42}$
- C) $\frac{43}{72}$
- D) $\frac{35}{122}$

Pyetja 179.

Një turist harxhoi $\frac{2}{9}$ e lekëve që kishte për udhëtim, $\frac{7}{18}$ për hotelin e $\frac{1}{3}$ për ushqim. Në fund i mbetën edhe 2500lekë.Sa lekë kishte ai në fillim:

- A) 42000
- B) 36000
- C) 45000
- D) 35000

Pyetja 180.

Një copë stof është e gjatë 30m. Ajo ndahet në dy pjesë, në mënyrë të tillë që njëra është sa $\frac{3}{7}$ e tjetrës. Sa është gjatësia e pjesës së madhe:

- A) 21 m
- B) 22m
- C) 24m
- D) 25 m

Pyetja 181.

Një copë stof është e gjatë 30m. Ajo ndahet në dy pjesë, në mënyrë të tillë që njëra është sa $\frac{3}{7}$ e tjetrës. Sa është gjatësia e pjesës së vogël:

- A) 10m
- B) 9m
- C) 8m
- D) 8,5m

Pyetja 182.

Sa është P.M.M.P. i këtyre tre numrave (21, 35, 140):

- A) 9
- B) 7
- C) 5
- D) 3

Pyetja 183.

Sa është P.M.M.P. i këtyre tre numrave (27, 99, 243):

- A) 3
- B) 7

- C) 9
- D) 13

Pyetja 184. Sa është P.M.M.P. i këtyre tre numrave (22, 77, 121):

- A) 3
- B) 7
- C) 11
- D) 13

Pyetja 185. Sa është SH.M.V.P. i këtyre tre numrave [14, 154, 49]:

- A) 968
- B) 1078
- C) 13123
- D) 211288

Pyetja 186. Sa është SH.M.V.P. i këtyre tre numrave [12, 40, 68]:

- A) 2040
- B) 2370
- C) 2720
- D) 5490

Pyetja 187. Sa është SH.M.V.P. i këtyre tre numrave [72, 16, 60]:

- A) $2^4 \cdot 3^2 \cdot 5$
- B) $2^3 \cdot 3^4 \cdot 5$
- C) $2^2 \cdot 3^3 \cdot 5^2$
- D) $2^1 \cdot 3^2 \cdot 5^3$

Pyetja 188.

Përmasat e një drejtkëndëshi janë: $a=2\frac{1}{3}m$ dhe $b = 3\frac{1}{2}m$ Sa është syprina e drejtkëndëshit:

- A) $6\frac{1}{6}m^2$
- B) $5\frac{5}{6}m^2$
- C) $5\frac{2}{3}m^2$
- D) $6\frac{2}{3}m^2$

Pyetja 189.

Një zotëri kishte në bankë 24000 lekë. Tërhoqi në fillim $\frac{1}{6}$ e tyre dhe më pas edhe $\frac{2}{5}$ e mbetjes. Sa lekë i kanë mbetur akoma në llogarinë bankare:

- A) 12000
- B) 12500
- C) 13000
- D) 13500

Pyetja 190.

Pasi shpenzova $\frac{2}{5}$ e lekëve, shpenzova edhe $\frac{9}{16}$ e pjesës që mbeti. Sa lekë kam patur në fillim, nëse më kanë mbetur ende edhe 4200 lekë:

- A) 1700
- B) 1600
- C) 1500
- D) 1400

Pyetja 191.

Duke shkruar numrin e përzier $2\frac{7}{25}$ si numër dhjetorë cili do të jetë rezultati i vërtetë:

- A) 0,56
- B) 0,57
- C) 2,28
- D) 22,8

Pyetja 192.

Duke shkruar numrin e përzier $2\frac{3}{15}$ si numër dhjetorë cili do të jetë rezultati i vërtetë:

- A) 2,2
- B) 3,3
- C) 6,6
- D) 0,22

Pyetja 193.

Duke shkruar numrin e përzier $3\frac{12}{15}$ si numër dhjetorë cili do të jetë rezultati i vërtetë:

- A) 1,9
- B) 3,8
- C) 5,7
- D) 0,19

Pyetja 194.

Shuma e numrave $0,59+1,51$ është e barabartë me shumën e dy numrave ku njëri është nëntë herë më i vogël se tjetri. Cilët janë këto numra:

- A) 0,23 dhe 2,07
- B) 0,22 dhe 1,98
- C) 0,21 dhe 1,89
- D) 0,20 dhe 1,80

Pyetja 195.

Numri $\frac{5}{8}$ duke u kthyer në përqindje është:

- A) 1,25%
- B) 6,25%
- C) 12,5%
- D) 62,5%

Pyetja 196.

20% e 35 nxënësve të një klase janë frekuentues të rregullt të bibliotekës së shkollës. Sa nxënës nuk e frekuentojnë rregullisht bibliotekën e shkollës:

- A) 30 nxënës
- B) 28 nxënës
- C) 26 nxënës
- D) 7 nxënës

Pyetja 197.

Sa kilogram vaj nxerrin 133kg ullinj duke ditur se nga 1 kv ullinjë nxirret 20 kg vaj:

- A) 26kg
- B) 26,4kg
- C) 26,6kg
- D) 26,8kg

Pyetja 198.

Në një kuti 3 nga 20 lapsa janë të kuq, 7 të zinj, të tjerët blu. Sa përqind e lapsave janë jo të zinj:

- A) 55%
- B) 60%
- C) 62%

D) 65%

Pyetja 199. Paga e një puntori, i cili paguhej në dollar u rrit 20%. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë:

- A) Paga e puntorit është 120\$ më shumë.
- B) Paga e puntorit është 20\$ më shumë.
- C) Paga e puntorit u bë sa 120% e pagës së vjetër.
- D) Paga e puntorit u bë sa 20% e pagës së vjetër.

Pyetja 200. Brinja e një katrori është 6,4cm ose sa 80% e brinjës së një trekëndëshi barabrinjës. Gjeni perimetrin e trekëndëshit:

- A) 20 cm
- B) 24 cm
- C) 28 cm
- D) 30 cm

Pyetja 201.

Çmimi i një malli, pasi u ul 30%, u bë 3640 lekë. Gjeni sa ishte çmimi i mallit në fillim:

- A) 5500 lekë
- B) 5400 lekë
- C) 5200 lekë
- D) 5100 lekë

Pyetja 202.

Sa është vlera e bazësg:

$$324 = (1300)_g$$

- A) $g=3$
- B) $g=4$

- C) $g=5$
- D) $g=6$

Pyetja 203.

Sa është vlera e bazës g :

$$2020 = (3744)_g$$

- A) $g=9$
- B) $g=8$
- C) $g=7$
- D) $g=6$

Pyetja 204.

Sa është vlera e shifrës x :

$$1123 = (3x63)_7$$

- A) $x=0$
- B) $x=1$
- C) $x=4$
- D) $x=6$

Pyetja 205.

Sa është vlera e shifrës x :

$$9987 = (14x26)_9$$

- A) $x=0$
- B) $x=2$
- C) $x=4$
- D) $x=6$

Pyetja 206.

Sa është vlera e shifrës x :

